



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-60/07 dt. 19/12/2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Bekim Lestrani, më datë: **30.12.2024** (E hënë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal e datës 29.11.2024.
2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2025.
3. Plani i punës Kryetarit të Komunës Drenasit për vitin 2025
4. Plani i punës për vitin 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. Plani i veprimit për transparencë komunale.
6. Rregullore për transparencë komunale.
7. Lista e Rreziqeve komunale për vitin 2025.
8. Raport i vlerësimit të rreziqeve për Komunën e Drenasit gjatë vitit 2024.
9. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2024.
10. Informim i punës në Kuvendin Komunal për aktivitetet e Këshillit për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKS-së për gjashtëmujorin dytë të vitit 2024.
11. Të ndryshme .

Drenas, 19.12.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02Nr. 060/04-59469 dt. 16.12.2024

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 29.11.2024, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK), Sali Dvorani (DD).

Munguan: Florentina Elezi (LVV), Mergim Piraku (DD) dhe Mirlinda Dvorani (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues nga Zyra e informimit.

Prezent ishin 28 anëtarë të Kuvendit Komunal.

Mbledhja filloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas më 31.10.2024;
2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954, më 30.09.2024;
3. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220, më 19.09.2024;
4. Propozim-vendim për miratimin përfundimtar të Raportit të komisioneve komunale për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
5. Propozim-vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe t'i rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, përshëndetje për të gjithë, fjalën e merr Egzona.

Egzona Terdevci, unë propozoj që pika katër të na vijë në një seancë tjetër, ku ne e shohim raportin, kjo çka ka ardhur është vetëm propozim-vendimi, edhe nuk e kemi të çartë kujt sa ju ka vlerësuar dëmi. Dy vendimet e para ju kemi thënë edhe me herët ku ka propozime për shfuqizim të vendimeve është mirë me i dërguar me materiale dhe vendimet si po shfuqizohen normal që mundemi me i gjet të seancat e më hershme, po nuk është problem për juve me i mbledh edhe me i dërguar si materiale të kompletuara.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se, sa i përket pikës së katër, ne kemi vetëm me miratuar si Kuvend as nuk bëjmë vlerësim, sepse ato i bënë Qeveria, sa i përket vendimeve për kthimin e ligjshmërisë i kemi ndryshuar me vendimet e fundit edhe duhet me i anuluar ato të më hershmet.

Egzona Terdevci, tha së këtu po shkruan Raporti përfundimtar i komisioneve komunale, pra komisionet janë të Komunës unë nuk po kërkoj asgjë, thjesht po dua me ditë sa ju ka vlerësuar dëmi.

Drejtoresha e Bujqësisë Anita Avdullahu, tha se komisioni ka bërë vlerësimin në bazë të kërkesave të qytetarëve nuk kanë qenë vetëm kërkesa të dëmeve në bujqësi në përgjithësi vlerësimi është bërë në bazë të çmimorëve të tregut dhe kjo shkon për komisionin qendror të Zyrës së Kryeministrit, është një material voluminoz nëse je e interesuar mundesh me shikuar për se cilin veç e veç mundeni me ardhur dhe ua prezantojmë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës ,dhe rendi i ditë kaloi me **26 vota” Për”, Kundër” 2, “Abstenim” 0**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani hapi për diskutim pikën 1: Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 31.10.2024, pasi nuk pati vërejtjeje as diskutime pika e parë e rendit të ditës kalon më vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2: Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954, më 30.09.2024.

Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën 2: Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954, më 30.09.2024, **Kryesuesi konstatoi se më 26 vota” Për”, Kundër” 2, “Abstenim” 0, u miratua pika dytë e rëndit të ditës**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3: Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220, më 19.09.2024.

Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën 3, **25 vota” Për”, Kundër”0 , “Abstënim” 2 kaloi pika e tret rëndit të ditës.**

Kryesues i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4: Propozim-vendim për miratimin përfundimtarë të Raportit të komisioneve komunale për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani** hodhi në votim pikën 4: Propozim-vendim për miratimin përfundimtarë të Raportit të komisioneve komunale për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Me **24 vota” Për”, Kundër”0 , “Abstënim” 4 kaloi pika e katër e rëndit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 5: Propozim-vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave për negocim.

Egzona Terdevci, tha unë i kam lexuar kërkesat që na keni dërguar dhe ka raste se kur për të njëjtën pronë është më shumë së një ofertues në këtë situatë nuk me duket e drejtë që me u bërë dhënia e pronave në shfrytëzim. Ne si VV-je, jemi kundër dhënies së pronave në shfrytëzim për 99 vjet, sidomos për pompa, markete që ka mjaftueshëm në Drenas që nuk sjellin asnjë përfitim. Tjetra nëse janë më shumë se sa dy kërkesa nuk është e drejtë me bërë negocim se dikujt i hyjmë në hak në emër të VV, propozoj që, mënyra e dhënies së pronave në shfrytëzim të bëhet me ankand publik pasi po thonë që jemi Komunë transparente.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se ky është një komision që formohet nga Kuvendi, ju propozoni anëtarët sipas ligjit, PDK-ja 2 anëtarë, DD-1 anëtarë, VV-1 anëtar, LDK-ja 1 anëtar, AAK-ja 1 anëtarë, GREEN-1 anëtarë, ka sa ju takojnë unë i kam dy prej ekzekutivit edhe prej shoqërisë civile, për dhënien e pronave vendos Kuvendi, Kryetari nuk jep prona.

Egzona Terdevci, tha së krahasimi me një projekt zhvillimor si është Paraku i biznesit, me këto pronat që i jep për me ndërtuar klient për fushat e me i mirëmbajt shoqëritë që i ke nuk është me vend le të mbetet në vlerësimin tënd.

Rruga nuk po bëhet se nuk është kryer shpronësimi, kur kryhet shpronësimi bëhet ka buxhet të ndarë edhe për këtë marr përgjegjësi se nuk është kryer shpronësimi. Njërin prej pronave që e ke në listën në ofertë për me dhënë në shfrytëzim listën e pronave paraprake nuk mundesh me dhënë në vitin 2024, se parcelat në Kishnarekë i ke hekë qysh po donë me jep një pronë që se ke në listë.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci tha se, kjo pronë nuk është listë për dhënien e pronave në shfrytëzim, po është në mbrojtje e kemi cekë edhe në mbledhjen e kaluar. Sa i përket shpronësimit të rrugës Komoran, Drenas, Gllobar, jeni duke e mashtruar opinionin mundesh me hyrë në gjeo portal e sheh se jemi e vetmja komunë që e kemi futur në gjeo portal rrugën katër korsi që është e shpronësuar 27-28 metra gjerësi, e neve na duhen 17 metra për me e kryer punën. Edhe Kryeministrit ja kemi kujtuar kur kemi pasur takim me kryetarët e komunave edhe ministrat e infrastrukturës, sepse është e vetmja rrugë që nuk ka gjakderdhje financiare, por nuk kanë vullnet me përfunduar këtë çështje.

Mehdin Salihu, kryesues e kam një vërejtje të përfaqësimi i subjekteve në hartimin e këtij komisioni. DD-ja, duhet të ketë edhe një anëtar nuk është e drejtë ne më shtatë asamblist të jemi të barabartë më të tjerat parti që e kanë nga një anëtar.

Arbër Halilaj, lidhur me këtë pikë tha se, mua me vjen mirë që janë 22 kërkesa për dhënien në shfrytëzim afatgjatë nga kompani mjaft serioze që do të ishte mirë të investonin në komunën tonë. Mirëpo kjo që po thirremi të Ligji nr.06L092 neni 11, e drejta e negocimit shfrytëzohet në rastin kur investimi është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm të vitit paraprak për investime kapitale, po janë edhe dy pika tjera të cilat besoi nuk i eliminojnë edhe investitorët tjerë që parashtrojnë investime nën atë vlerë.

Nëse me kujtohet në 2023, është gjashtë milion e gjysmë buxheti për investime kapitale, mirëpo pika 3.2 d.m.th nëse biznesi planifikon të hapet është biznes në interes të Komunës, ose në 3.3 në rastet kur ka interesim për marrjen e pronës së Komunës nga pala e cila nuk ka pasur interesim 3 vitet e fundit ku mundë të thirremi edhe në këto dy pikat tjera dhe mos të eliminojmë asnjërin nga ofertuesit. E di që është përgjegjësi ekskluzive e Kuvendit me i dhënë pronat, një nga format është kjo një negociim që unë e siguroj sikur formë transparente dhe jam që të jemi pjesë e këtij komisioni duke mos pasur me këto gabime që po behën praktike gjithmonë që GREEN është gjithmonë mbas LDK-së dhe AAK-së.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se, unë po kërkoj me e formuar një komision për me i shqyrtuar këto kërkesa me i rekomanduar, mua me intereson me pas miratimin e të gjithëve.

Azemine Gjoka, besoi mjafton një kandidat nuk ka nevojë me shumë nga radhët e DD.

Valentina Leku, nga grupi i PDK-së kemi dy propozime, Gani Krasniqi dhe Laurita Muhadri-Bujupi.

Marigona Bazaj, nga grupi i DD-së, propozojmë për anëtare Azemine Gjoka.

Filloreta Bujupi, nga grupi LVV-së, propozojmë anëtare Egzona Terdevci.

GREEN-Arbër Halilaj, anëtar.

LDK-Egzon Qorri, anëtar.

AAK-Beqir Kiqina anëtar.

Kadire Tahiraj, anëtare nga Shoqëria Civile.

Arigon Sinani, unë e propozoj Qendrim Mullen.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se, nuk ka propozime prej palës së tretë, propozimet janë prej grupeve ashtu si u dakorduat, ekzekutivi propozon Arben Shalen dhe Kadire Tahiraj anëtare nga Shoqëria Civile.

Arigon Sinani, nuk ka të drejtë asambleisteja nga radhët e PDK-së, që po thonë së nuk është me PDK-në, në bazë të KQZ-së, nuk është konsultuar me askënd prej neve, por nëse e keni bërë për pazare të juaja ajo është diçka tjetër.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, propozimet se kush me fol në emër të grupit e përcakton shumica pra zonja në fjalë është apo nuk është shefe e grupit pak rëndësi ka

kush donë me e votuar komisionin që do ta ndihmon punën e voton dhe kush ka fakte për pazare dëshmoni në polici.

1. **Arben Shala**, anëtar nga Ekzekutivi;
2. **Gani Krasniqi**, anëtar nga PDK-ja;
3. **Laurita Muhadri-Bujupi**, anëtar nga PDK-ja;
4. **Azemine Gjoka** anëtare nga DD-ja;
5. **Egzona Terdevci**, anëtare nga VV-ja;
6. **Arbër Halilaj**, anëtar nga GREEN;
7. **Egzon Qorri**, anëtar nga LDK-ja;
8. **Beqir Kiqina**, anëtar nga AAK-ja;
9. **Kadire Tahiraj**, anëtare nga Shoqëria Civile.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 5: Propozim-vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuara për dhënie të pronave me negocim. **Me 24 vota” Për”, Kundër”2 , “Abstënim” 1 kaloi pika e pestë e rëndit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim piken 6: **Të ndryshme.**

Egzona Terdevci, të lutem gjuhën jo parlamentare mos me lejuar, mos me qenë duke udhëhequr dikush tjetër pasi jeni zgjedhur kryesues bëjë detyrën që të takon. Kam një çështje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit Muhamet Gjokën, që në shkollën “Dëshmoret e Drenicës” në Çikatovë të vjetër janë ankuar së kanë mungesa të hapësirës dhe kabinete të kimisë, të fizikës, biologjisë që i kanë shndërruar në klasa njëjtë edhe kabinetin e informatikës për të cilën kanë thënë që është shumë e ftohtë si klasë. E di që nuk është direkt vetëm kompetencë e Komunës por a jeni në rrjedha për këtë çështje edhe a keni mundur me bërë diçka.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit Muhamet Gjoka, tha se në buxhetin e vitit të ardhshëm është planifikuar një masë buxhetore për ndarjen e klasave kabineteve në mënyrë që minimumi 60% të shkollave të punojnë me një ndërrim që të krijojmë kushte për mësimin tër ditor në projektin e vitit të ardhshëm.

Egzona Terdevci, çmoi përpjekjen për mësim tër ditor, por e shohë që nuk je i informuar për gjendjen në Çikatovë se nuk po e din si është. Ata po ankohen se kanë mungesë të hapësirave të mësimi, pra kabinetet janë detyruar me i bërë klasa ato e kanë gjendjen e keqe të ftohtë, po e kuptoi qëllimin e mirë për mësimin tër ditor, po derisa të behët mësimi tër ditor ato klasë që nuk e kanë gjendjen e mirë a mundemi me bërë diçka për me i rregullua.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit Muhamet Gjoka, tha se, ne po flasim për krijimin e hapësirave për mësim me një ndërrim, mësimi me një ndërrim do të jetë parakusht dhe është planë i Drejtorisë së Arsimit. Në shkollat ekzistuese do t’i bëjmë intervenimet e nevojshme që të mundësojmë mësimin me një ndërrim, po ashtu edhe mësimin tër ditor por për shkaqe të infrastrukturës ende nuk po mundemi me filluar.

Egzona Terdevci, a duhet me i sakrifikuar kabinetet me i shndërruar në klasa mos te kishte kabinete për me mbajtë mësim tërë ditë, a duhet me sakrifikuara sallën e arsimitarëve me improvizuar në korridor. Unë jam për mësim tërë ditë veç se pari është dashtë se cila klasë ishte dashur të këtë një objekt ku mundet me u zhvilluar mësimi edhe për mësimdhënësin edhe për nxënësin, e pastaj me menduar për mësim tërë ditë nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme nuk po me duket e drejtë.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit Muhamet Gjoka, vetëm mos t'i ngatërrojmë, unë e thashë si parapërgatitje aty ku ka hapësira sigurisht do të shikohen të gjitha mundësit brenda shkollës.

Azmine Gjoka, pres nga drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Endrit Gllareva, me na dhënë një përgjigjeje për dy çështje që i kemi ngritur në mbledhjen e kaluar për atë të ujit dhe kanalizimit.

Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Endrit Gllareva, tha se, ne vazhdimisht jemi duke punuar në rrjetin e ujësjellësit normalisht që kemi shumë probleme një projekt që është punuar në vitin 2010-2015. Nuk është e lehtë me e rehabilituar kështu që ne rrjetin primar veç e kemi përfunduar. d.m.th ka mburritur uji në Shtuticë, Terstenik, Poklel, Korroticë, tash vetëm e kemi shpallë fazën tjetër lidhjet sekondare dhe shumë shpejt do të vazhdojmë edhe me rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe mundemi me dhënë data, por jemi duke punuar në atë drejtim.


Arben Shala nënkryetar, zonja Terdevci disa shqetësime sa i përket shpronësimit të rrugës Gllabar – Komoran, dua të ju njoftoj se rruga është e shpronësuar edhe i kem hartat, por ajo që tha zonja Terdevci nuk është e vërtetë.

Egzona Terdevci, unë e kam konfirmimin prej Ministrisë që nuk është kryer shpronësimi, kur të doni e vërtetojmë së bashku dhe i qëndroi mbrapa fjalës sime.

Mbledhja përfundoi në ora 13:18

Me gjerësisht mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 29.11.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, ose në rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube <https://fb.ëatch/vT0-u9Aa6G/>.

Procesmbajtëse:




Fakete Hoti




Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02Nr. 030/01 - 59123 dt. 12.12 /2024

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN
2025

Dhjetor, 2024

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

Pasqyra e planit

Parathënie.....	02
Janar.....	05
Shkurt.....	06
Mars.....	07
Prill.....	08
Maj.....	09
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nëntor.....	15
Dhjetor.....	16

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështet në **LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE**, Statutin e Komunës, rregulloret në fuqi, udhëzimeve administrative dhe akte të tjera nënligjore. Siguron kushte të punës për seanca të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve, për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe çdo gjë në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Funksionimi i kuvendit të komunës

Kuvendi i komunës funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, Statutit të Komunës, Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës se Drenasit dhe akteve të tjera nënligjore dhe udhëzimeve administrative ne fuqi.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Drenasit për vitin 2025

Plani i punës së Kuvendit ka për qëllim planifikimin paraprak të punës për vitin 2025 dhe i bashkërenditur me aktivitetet e Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025. Plani i Punës e përmbledh punën një vjeçare të Kuvendit, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen dhe dalin si nevoja për shqyrtim në Kuvend, do të trajtohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, Statutit të Komunës se Drenasit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës se Drenasit. Në këtë mënyrë, në Planin e Punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta që do të mbahen për vitin 2025, mbledhjet do të mbahen javën e fundit të çdo muaji, përjashtimisht në rast kur mund të përcaktohet ndryshe.

Kryesuesi i kuvendit të komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e kuvendit të komunës. Kuvendi i Komunës mban së paku njëmbëdhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njohohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njohimin e tillë shkruhet: a) data e mbajtjes së mbledhjes; b) koha e mbajtjes së mbledhjes; c) vendi i mbajtjes së mbledhjes; d) rendi i ditës për mbledhje; dhe e) materialet e mbledhjes. f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës mbanë:

1. Mbledhje inauguruese
2. Mbledhje të rregullta
3. Mbledhje të jashtëzakonshme
4. Mbledhje urgjente
5. Mbledhje solemne.

Ftesa për mbledhjen inauguruese i dërgohet shtatë (7) ditë punë para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Në raste të veçanta ftesa mund të dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Ftesa për mbledhjen e rregullt i dërgohet shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Ftesa për mbledhjen e jashtëzakonshme i dërgohet tre (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes anëtareve të kuvendit dhe autoritetit mbikëqyrës.

Ftesa për mbledhjen e urgjente procedurat për thirrjen e mbledhjes nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve të tjera të kuvendit të komunës, mbledhja urgjente thirret në rast të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave tjera urgjente në komunë.

Planifikimi i mbledhjeve të KK –së dhe çështjet që do të trajtohen gjatë vitit 2025

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

JANAR 2025

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.							
2.	Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024 (TM4)	Zyra e kryetarit dhe Drejtoritë Komunale	DBF	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
3.	Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024.	Drejtoritë dhe Zyrat komunale	Zyra e Kryetarit	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
4.	Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025	Koordinatorja	Zyra e Kryetarit	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë dhe Zyrat komunale	Zyra e Kryetarit	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
6.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
7.	Raport nga Komisioni për emërtimin e rrugëve	Kuvendi	Komisioni	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	
8.	Raporti i Komiteteve për vitin 2024	Kuvendi	Komitete	14.01.2025	KPF 21.01.2025	31.01.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

SHKURT 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.02.2025	KPF 19.02.2025		Afati kohor 17.02.2025
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.02.2025	KPF 19.02.2025	28.02.2025	MBLEDHJE SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 17 SHKURTIT, DITËS SË SHPALLJES SË PAVARSISË SË KOSOVËS
3.	Raporti i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2024 dhe plani i implementimit të rekomandimeve	NJAB	Zyra e Kryetarit		KPF 19.02.2025		
4.	Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e Rregullores për dhënien e dekoratave, çmimeve dhe mirënjohjeve.	Drejtoritë	Kuvendi				

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

MARS 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS			Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend AKTIVITETET	05.03.2025
		Dytësor	Parësor					
1.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	11.03.2025	KPF 18.03.2025	28.03.2025	Mbledhje Solemne e Kuvendit të Komunës Drenas kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të	
2.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Kuvendi	Zyra e Kryetarit	11.03.2025	KPF 18.03.2025	28.03.2025		
3.	Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve nga ZKA për vitin 2023	Grupi Punues	Zyra e Kryetarit	11.03.2025	KPF 18.03.2025	28.03.2025		
4.	Raport i punës dhe aktiviteteve të NPL "Stacioni i Autobusëve" dhe KRM "Pastrimi" për vitin 2024	DSHPE	Ndërmarrjet	11.03.2025	KPF 18.03.2025	28.03.2025		

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

PRILL 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar TM1 për vitin 2025	DF	Kryetari i Komunës	14.04.2025	KPF 21.04.2025	30.04.2025	9 Prill Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	14.04.2025	KPF 21.04.2025	30.04.2025	
3.	Raport i punës së Komisioneve të formuara nga Kuvendi për periudhën Janar-Mars 2025	Drejtoritë	Komisionet	14.04.2025	KPF 21.04.2025	30.04.2025	
4.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Kuvendi	Zyra e Kryetarit	14.04.2025	KPF 21.04.2025	30.04.2025	
5.	Informatë nga Drejtoritë për Anëtarët e Kuvendit për periudhën Janar-Mars 2025	Zyra e Kryetarit	Drejtoritë Komunale	14.04.2025	KPF 21.04.2025	30.04.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

MAJ 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë lidhur me qarkoren Buxhetore 2025 dhe planifikimi i veprimit për dëgjime Buxhetore	DBF	Kryetari i Komunës	15.05.2025	KPF 22.05.2025	30.05.2025	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.05.2025	KPF 22.05.2025	30.05.2025	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.05.2025	KPF 22.05.2025	30.05.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

QERSHOR 2025

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft – korniza afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2025-2026-2027	DBF	Kryetari i Komunës	13.06.2025	KPF 18.06.2025	27.06.2025	MBLEDHJEN SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 14 QERSHORIT, DITËS SË ÇLIRIMIT TË DRENASIT
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.06.2025	KPF 18.06.2025	27.06.2025	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.06.2025	KPF 18.06.2025	27.06.2025	
4.	Miratimi i Rregullores për dhënie e dekoratave, çmimeve dhe mirënjohjeve	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.06.2025	KPF 18.06.2025	27.06.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

KORRIK 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2025	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	17.07.2025	KPF 22.07.2025	31.07.2025	Afati kohor
2.	Diskutim i Raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2024 për Komunën e Drenasit (Gillogocit)		Kryetari i Komunës	17.07.2025	KPF 22.07.2025	31.07.2025	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	17.07.2025	KPF 22.07.2025	31.07.2025	
4.	Raporti Financiar Janar-Qershor 2025 (TM2)	DBF	Kryetari i Komunës	17.07.2025	KPF 22.07.2025	31.07.2025	
5.	Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.	Anëtarët e KKSBB-së	Koordinatorja	17.07.2025	KPF 22.07.2025	31.07.2025	
6.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	17.07.2025	17.07.2025	31.07.2025	
7.	Diskutimi i Planit të Veprimit për implementimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA për vitin 2024			17.07.2025	17.07.2025	31.07.2025	
8.	Raporti i kryetarit të Komunës për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përbushjes së qëllimit të dhënies në			17.07.2025	17.07.2025	31.07.2025	

	shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale							
9.	Raport nga Komisioni për emërtimin e rrugëve	Komisioni për emërtim te rrugëve	Kuvendi i Komunës	17.07.2025	17.07.2025	31.07.2025		

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025
 Gusht, Pushim 2025

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

SHTATOR 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.			15.09.2025	KPF 22.09.2025	30.09.2025	Afati kohor
2.	Shqyrtimi i Draft -Buxhetit final, dhe marrja e vendimit për buxhet për vitet 2025-2027	DBF	Kryetari i Komunës	15.09.2025	KPF 22.09.2025	30.09.2025	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	15.09.2025	KPF 22.09.2025	30.09.2025	
4.	Diskutim rreth raportit të Progresit në lidhje me Implementimin e Rekomandimeve të dhëna nga ZKA për vitin fiskal 2024			15.09.2025	KPF 22.09.2025	30.09.2025	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

TETOR 2025

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar Janar-Shtator 2025 (TM3)	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.10.2025	KPF 22.10.2025	31.10.2025	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.10.2025	KPF 22.10.2025	31.10.2025	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.			13.10.2025	KPF 22.10.2025	31.10.2025	
4.	Informatë nga Drejtoritë për Anëtarët e Kuvendit për periudhën Korrik-Shtator 2025						
5.	Diskutim i raportit për performances Komunale						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

NËNTOR 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.		Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.11.2025	KPF 19.11.2025	27.11.2025	28 Nëntor SEANCË SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS ME RASTIN E FESTËS SË 28 NËNTORIT, DITËS SË FLAMURIT, DITËLINDJES SË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.11.2025	KPF 19.11.2025	27.11.2025	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.						

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2025

DHJETOR 2025

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TET
		Dytësor	Parësor				

										Afati kohor
1.	Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026	Kryetari i Komunës	Kuvendi i Komunës	10.12.2025	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
2.	Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2026	Drejtoritë përkatëse	Kryetari i Komunës	10.12.2025	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
3.	Lista e rreziqeve për vitin 2026	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
4.	Trajtimi i çështjeve tjera në procedurë për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal.	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
6.	Raport për zbatim të Planit të Integritetit për vitin 2025	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
7.	Raporti i vitit 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	Kordinator/ja	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			
8.	Miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2026	Kordinator/ja	Kryetari i Komunës	10.12.2024	KPF	15.12.2025	26.12.2025			

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka planifikuar që gjatë vitit 2025, të mbaj gjithsej 11 mbledhje, këtë Plan ja bashkëngjisim edhe orarin e takimeve që do të mbahen për secilin muaj.

DRENAS – 11.12.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani

Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 030/01-59123 dt. 12. 12 2024

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe rregullores për punën e Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2025 planifikoi këtë:

Orari i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2025.

Janar Mbledhja e KPF-a me dt. 21.01.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 31.01.2025	Shkurt Mbledhja e KPF-a me dt. 19.02.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 28.02.2025	Mars Mbledhja e KPF-a me dt. 18.03.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 28.03.2025
Prill Mbledhja e KPF-a me dt. 21.04.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.04.2025	Maj Mbledhja e KPF-a me dt. 22.05.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.05.2025	Qershor Mbledhja e KPF-a me dt. 18.06.2025, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 27.06.2025
Korrik Mbledhja e KPF-a me dt. 22.07.2025, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt.31.07.2025	Gusht PUSHIM	Shtator Mbledhja e KPF-a me 22.09.2025, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 30.09.2025
Tetor Mbledhja e KPF-a me 22.10.2025 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 31.10.2025	Nëntor Mbledhja a e KPF-a me 19.11.2025, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 27.11.2025	Dhjetor Mbledhja e KPF-a me 15.12.2025, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 26.12.2025

DRENAS, 2024

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani

